



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 shtator 2024
Nr. Ref.: RK 2526/24

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI136/23

Parashtrues

Kamer Kameri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Kamer Kameri, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të paspecifikuar.
4. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka specifikuar të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë shkelur.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr.01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 15 qershor 2023, kërkesa u dorëzua në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
8. Më 27 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR. KI136/23 caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI136/23 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
9. Më 3 korrik 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, dhe i kërkoi sqarime shtesë, përkatësisht që të: (i) plotësonte formularin e kërkesës; (ii) të specifikonte cilin akt të autoritetit publik e konteston dhe; (iii) të cekte të drejtat dhe liritë të cilat pretendon se i janë shkelur.
10. Më 7 gusht 2023 dhe 22 gusht 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë, mirëpo nuk e plotësoi dhe qartësoi kërkesën e tij.
11. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
12. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës vendimin për refuzimin e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar në termocentralin “Kosova A” në Obiliq.
14. Në vitin 1995, parashtruesi i kërkesës e fitoi të drejtën e pensionit invalidor për shkak të lëndimeve të rënda fizike që i kishte pësuar në vendin e punës, duke i shkaktuar paaftësi të përhershme.
15. Institucioni i Avokatit të Popullit lëshoi një opinion ligjor nr. 25/2016 lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Grudić kundër Serbisë*, nr. 31925/08. Në këtë opinion theksohej si në vijim:

“Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës më 15 shkurt 2016 lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), për rastin Grudić kundër Serbisë, me numër 31925/08 (2012)”.

“Në deklaratën hyrëse të këtij Opinioni, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës shpreh shqetësimin e tij për mospërbushjen e obligimeve të Republikës së Serbisë ndaj pensionistëve të Kosovës, sipas aktgjykimit të GJEDNJ-së, në vitin 2012, për rastin Grudić kundër Serbisë. Aktgjykimi i GJEDNJ-së në rastin Grudić kundër Serbisë, është aktgjykim parimor, me të cilin Serbia është e obliguar t'i kompensojë në mënyrë të njëjtë, sipas aktgjykimit të lartpërmendur, pensionet kontributpaguese, pensionet invalidore të punës dhe pensionet familjare, për qytetarët e Kosovës, të cilët i kanë gëzuar këto pensione deri në vitin 1999, kur edhe janë ndërprerë nga Serbia në mënyrë arbitrare”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës thekson se ishte i punësuar në termocentralin “Kosova A” në Obiliq. Në vitin 1995, për shkak të lëndimeve të rënda fizike që i kishte pësuar në vendin e punës, e fitoi të drejtën e pensionit invalidor. Parashtruesi i kërkesës thekson se që nga viti 1998 e deri më tash, asnjëherë nuk e mori pensionin që i takonte.
17. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi në favor të pensionistëve shqiptar që ishin të punësuar në kohën e ish-Jugosllavisë, dhe detyroi shtetin e Republikës së Serbisë që t'i kompensojë ata. Parashtruesi i kërkesës ia ka bashkëngjitur kërkesës së tij një opinion të institucionit të Avokatit të Popullit, në të cilin shkruhet si në vijim:

“Aktgjykimi i GJEDNJ-së në rastin Grudić kundër Serbisë, është aktgjykim parimor, me të cilin Serbia është e obliguar t'i kompensojë në mënyrë të njëjtë, sipas aktgjykimit të lartpërmendur, pensionet kontributpaguese, pensionet invalidore të punës dhe pensionet familjare, për qytetarët e Kosovës, të cilët i kanë gëzuar këto pensione deri në vitin 1999, kur edhe janë ndërprerë nga Serbia në mënyrë arbitrare”.

18. Parashtruesi i kërkesës thekson se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të bëjë pagesën e pensioneve ose të ushtrojë presion ndaj Republikës së Serbisë për pagesën e tyre. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të marrë vendim për realizimin e pensioneve të tij, të cilat nuk i kishte përfituruar nga viti 1998 e tutje.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 46, 47, 48 të Ligjit.

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

Neni 46

[Lejueshmëria]

Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore.

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

21. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullave 25, 54 dhe 74 të Rregullores së punës.

Rregulli 25

[Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve]

[...]

(e) mbrojtjen juridike të kërkuar;

(f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve;

(g) arsyetimin rreth pranueshmërisë dhe meritave të kërkesës; dhe

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

Rregulli 54

[Hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

(1) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur Gjykata përcakton se pretendimi:

(a) nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm; ose

(b) nuk përfaqëson një kontest.

(2) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se:

(a) kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës ose kërkesave nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose të qartësojë kërkesën;

[...]

Rregulli 74

[Kërkesa në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 46, 47, 48, 49 dhe 50 të Ligjit]

[...]

(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendohet se janë shkelur dhe se cili është akti konkret i autoritetit publik i cili kontestohet.

22. Parashtruesi i kërkesës thekson se kishte punuar në termocentralin “Kosova A” në Obiliq më shumë se 22 vite. Në vendin e punës kishte pësuar lëndime të rënda fizike. Në vitin 1995 iu kishte njohur e drejta për pension invalidor të kategorisë së parë, të cilën e mori deri në vitin 1998 kur iu ndërpre për shkak të fillimit të luftës në Kosovë. Parashtruesi i kërkesës thekson se, që nga viti 2000 kishte parashtruar kërkesa te institucionet shtetërore në mënyrë që të bënin presion te Serbia për kthimin e fondeve pensionale.
23. Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që ta plotësonte formularin e kërkesës; të specifikonte aktin e autoritetit publik që e konteston dhe të cekte të drejtat dhe liritë e njeriut që pretendon se i janë shkelur.
24. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi përsëri shkresa në Gjykatë mirëpo nuk e plotësoi dhe qartësoi kërkesën e tij. Parashtruesi i kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë akt të autoritetit publik të cilin e konteston.
25. Gjykata thekson se, rregulli 54 (2) (a) i Rregullores së punës parasheh që Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është jo e plotë ose e paqartë, përkundër kërkesës nga Gjykata ndaj palës që ta plotësojë ose qartësojë kërkesën. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është jo e plotë dhe e paqartë, përkundër kërkesës së Gjykatës ndaj parashtruesit të kërkesës për ta plotësuar dhe qartësuar kërkesën e tij.
26. Gjykata rithekson se barra për ta plotësuar dhe qartësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesave, të cilët kanë interes juridik për t'i ngritur pretendimet e tyre. Në rastet kur parashtruesit e kërkesave nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata i shpall këto kërkesa si të paqarta dhe jo të plota dhe i refuzon me procedurë të shkurtër (shih, rastet e Gjykatës [KI01/23](#), *parashtrues Amir Hamza*, Vendim për refuzim të kërkesës i 14 dhjetorit 2023, paragrafi 42; [KI90/20](#), *parashtrues Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25).
27. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është jo e plotë dhe e paqartë, dhe rrjedhimisht kërkesa refuzohet me procedurë të shkurtër në përputhje me rregullin 54 (2) (a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47.1 të Ligjit dhe me rregullin 54 (2) (a) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJ kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani